



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 150 prot.

Kamëz, më 12.12.2021

V E N D I M

Nr. 115 Datë 12/12 2021

M B I

“PËR MIRATIMIN E VLERËS MAKSIMALE TË SUBVENCIONIMIT TË QIRASË DHE TË NIVELIT TË QIRASË MESATARE NË TREG TË LIRË PËR VITIN 2022”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot më 17.12.2021 në kushte të veçanta si pasojë e masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19 , pasi mori në shqyrtim Projekt-Vendim Nr.110 Datë 14.12.2021 në mbështetje të nenit 8, nenit 24, të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, të nenit 38, të ligjit nr.22/2018 “Për Strehimin Social”, pika 4/a e VKM nr. 362, datë 29.05.2019, “Kriteret e dhënies së subvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, Këshilli Bashkiak Kamëz”;

V E N D O S I:

1. Nivelin e qirasë mesatare mujore ne treg të lirë sipas strukturave të apartamenteve në territorin e Bashkisë Kamëz, si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Nr.Frymësh	Sasia	Çmimi mesatar (lekë pa tvsh)
1	Banesame qira (Apartament tip garsonierë)	muaj	1-2	1	13.000
2	Banesa me qira (Apartament 1 + 1)	muaj	3-4	1	18.000
3	Banesa me qira (Apartament 2 + 1)	muaj	5	1	21.000
4	Banesa me qira (Apartament 3 + 1)	muaj	6-8	1	24.000



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

2. Vlera maksimale e subvencionit të qirasë është e barasvlefshme me qiratë mesatare në tregun e lirë sipas vlerave të paraqitura në këtë vendim.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga **Prefekti i Qarkut Tiranë**.

Kryetar Këshilli
Hysen Koldashi

